Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-719 Datë: 30.07.2026

Në mbështetje të neneve 6,8,9 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Udhëzimit Administrativ (MASH) Nr.35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Rregulloren Nr. 01/196 e punës së Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë: 30.07.2026 merr:

VENDIM

1. **Akreditohet dhe Validohet** "Shehollkat Professional Academy" Adresa: Rr. Kosturi, Prishtina 10000, Arberi, Kosovë për periudhën tre (3) vjeçare (30.07.2026 - 30.07.2029), me kualifikimet:
   1.1. **Parukier/e** niveli III, sipas KKK-së, me numër total të kredive 17, kualifikim i bazuar në **Kualifikime Kombëtare Profesionale (D).** Për një cikël trajnohen 2 grupe, me gjithësej 30 kandidatë. Në një vit kalendarik, 8 grupe me nga 15 kandidatë. Gjithsej 120 kandidat me programin nga e hëna në të premte me 5 orë mësimore 45 minutëshe në ditë. Me planin e trajnimit në fundjavë planifikon dy grupe me nga 15 kandidatë secili gjithsej 30 kandidatë Për një vit kalendarik qendra planifikon të trajnoje gjithsej 150 kandidatë.
   1.2. **Grimer/e** niveli III, sipas KKK-së, me numër total të kredive 7, kualifikim i bazuar në **Kualifikime Kombëtare Profesionale (D).** Për një cikël trajnimi për programin me 140 orë, trajnohen 2 grupe, me gjithsej 30 kandidatë. Në një vit kalendarik, në total trajnohen 16 grupe me nga 15 kandidatë. gjithsej 240 kandidatë.

5. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Në bazë të kërkesës së "Shehollkat Professional Academy" të parashtruar në AKK, për akreditim dhe validim të "Shehollkat Professional Academy" Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) bazuar në dispozitat ligjore në fuqi ka caktuar ekipet e eksperteve të jashtëm me qëllim të vlerësimit të institucionit lidhur me përmbushjen e kritereve për akreditim dhe validim për kualifikimin si më lartë.

Ekipi i ekspertëve pas shqyrtimit të dosjes së aplikimit më: 05.05.2026 për kualifikimet: **Parukier/e** Niveli III dhe **Grimer/e** niveli III ndërsa vizita është realizuar me datën 15.05.2026. Pas përfundimit të procesit vlerësues, raportet janë realizuar me datë: 10.06.2026. Bazuar në analizimin e dosjes së aplikimit dhe të gjeturat me rastin e realizimit të vizitës si dhe raportet vlerësuese të ekipeve të ekspertëve janë proceduar për vendimmarrje në mbledhjen e Këshillit Drejtues të datës 30.07.2026.

Rekomandimet përfundimtare të ekipeve të ekspertëve janë mbështetur në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit si: aplikacionet për validim të kualifikimeve, aplikacionet për akreditim të institucionit, raportin e vetëvlerësimit të dorëzuar nga institucioni si dhe të gjeturave me rastin e realizimit të vizitave së realizuar tek pala aplikuese. AKK bazuar në nenin 18 të Ligjit Nr/03/L-060 Për Kualifikimet Kombëtare dhe nenin 23 të Udhëzimit Administrativ MASH Nr. 35/2014 Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë është e obliguar të realizoj procesin e monitorimit dhe të raportoj tek Këshilli Drejtues i AKK-së.
Andaj, Këshilli Drejtues i AKK-së, referuar dispozitave ligjore, rekomandimeve të ekipit të ekspertëve të dhëna në raportet vlerësuese përfundimtare për akreditim dhe validim të institucionit aplikues, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014, Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD së AKK, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të vendimit.*

Vendimi u dërgohet:

1. "Shehollkat Professional Academy"
2. Arkivit të AKK.

Prof. Dr. Besim Mustafa

Kryetar KD së AKK